



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 korrik 2023
Nr. ref.: RK 2232/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI38/22

Parashtrues

Elvis Durmaku

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit
PN. nr. 1297/21 të 28 janarit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu -Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Elvis Durmaku nga Smedereva, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [PN. nr. 1297/21] të 28 janarit 2022 të Gjykatës së Apelit (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktvendimin [P. nr. 69/21] të 17 dhjetorit 2021 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 5 [Gjuhët] dhe nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 4 prill 2022, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 12 prill 2022, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga përfaqësuesit ligjor të parashtruesit të kërkesës të dorëzojnë autorizimet për përfaqësim në Gjykatën Kushtetuese. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dorëzua edhe Gjykatës së Apelit.
7. Më 20 prill 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR. KI 38/22] caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu - Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 26 maj 2022, përfaqësuesi ligjor i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar.
9. Më 26 nëntor 2022, Gjykata kërkoi informata nga Gjykata Themelore në Gjakovë se në cilën fazë të procedurës është rasti i parashtruesit të kërkesës sipas aktakuzës [PP. II. nr. 250/19].
10. Më 7 dhjetor 2022, Gjykata Themelore në Gjakovë e njoftoi Gjykatën se vazhdimi i shqyrtimit kryesor është caktuar për datën 8 dhjetor 2022, ku me propozim të prokurorisë do të dëgjohen dëshmitarët, duke theksuar se të gjitha seancat janë mbajtur me praninë e një përfaqësuesi dhe një përkthyesi gjyqësor.

11. Më 5 qershor 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës është shtetas serb, pjesëtar i komunitetit ashkali, i cili për një kohë të gjatë jeton në territorin e Republikës së Kosovës, më saktësisht në territorin e komunës së Gjakovës. Parashtruesi i kërkesës është duke vuajtur dënimin me burg në burgun e Dubravës për kryerjen e një veprë penale të së njëjtës natyrë, por që nuk ka të bëjë me veprën që është objekt i kërkesës aktuale.
13. Më 7 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës u mor në pyetje si i dyshuar në stacionin policor në Gjakovë për shkak të dyshimit se kishte kryer disa vepra penale *ujedhjes së rëndë në vazhdimësi*. Me atë rast, parashtruesi i kërkesës është njoftuar me të drejtat e tij,
- „ 1. Për veprën penale për të cilën akuzohet,
 2. Për të drejtën për të heshtur dhe për të mos u përgjigjur në asnjë pyetje përveç informacionit mbi identitetin e tij/saj,
 3. Të drejtën në përkthim nëse ai ose ajo nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e personit që e drejton procedurën e marrjes në pyetje,
 4. Të drejtën për ndihmën e mbrojtësit dhe konsultimit me të para dhe gjatë marrjes në pyetje,
 5. Faktin se deklarimi i tij/saj mund të pendoret si provë para gjykatës,
 6. Faktin se ai/ajo mund të kërkojë marrjen e provave për mbrojtjen e tij/saj”.
14. Pasi u mor në pyetje, parashtruesi i kërkesës deklaroi se ka kuptuar të drejtat e tij dhe veprën penale që i vihet në barrë dhe nënshkroi procesverbalin e seancës në të cilën ai pranoi kryerjen e veprave penale, nuk kërkojë mbrojtje, përkatësisht përfaqësues. ndërsa e tërë procedura është zhvilluar në gjuhën shqipe pa asnjë kundërshtim nga ana e parashtruesit të kërkesës.
15. Më 9 shkurt 2019, Prokuroria Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) ngriti akt padi [PP. II. nr. 250/19] kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale *ujedhje e rëndë në vazhdimësi, nga neni 327 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 81 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK) dhe veprës penale ujedhje në vazhdimësi, nga neni 325 par. 2 lidhur me nenin 81 të KPRK-së*.
16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës u dërgua për të vuajtur dënimin me burg për kryerjen e një veprë penale të së njëjtës natyrë, por nuk ka asnjë lidhje me veprën që është objekt i kërkesës aktuale.
17. Më 11 nëntor 2021, Gjykata Themelore mbajti seancën e parë për këtë rast, e cila u mbajt në gjuhën shqipe me praninë e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës (i cili i ishte caktuar sipas detyrës zyrtare), në të cilën parashtruesi i kërkesës deklaroi se ai e kuptoi aktakuzën dhe se nuk ka nevojë për shpjegime shtesë, po ashtu lidhur me pranimin e fajësisë, parashtruesi deklaroi se nuk e pranon fajësinë. Duke pasur parasysh faktin se parashtruesi i kërkesës nuk e pranoi fajësinë, Gjykata Themelore caktoi një seancë tjetër më 13 dhjetor 2021.
18. Më 7 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për hedhjen e aktakuzës [PP. II. nr. 250/19] dhe kundërshtimin e provave të prokurorisë në Gjykatën Themelore, duke

kërkuar që aktakuza të hidhet poshtë sepse, sipas parashtruesit të kërkesës, ajo bazohet në prova të papranueshme dhe deklaratat e parashtruesit të kërkesës janë marrë pa praninë e përkthyesit, përkatësisht në gjuhën shqipe të cilën ai nuk e kupton.

19. Më 17 dhjetor 2021, Gjykata Themelore përmes aktvendimit [P. nr. 69/21] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për hedhjen poshtë të aktakuzës [PP. II. nr. 250/19] si të pabazuar, duke arsyetuar, „pretendimet e mbrojtësit se kinse deklaratat e dhëna në polici me dt. 07.02.2019 dhe 04.02.2021 janë marr në kundërshtim me dispozitat ligjore edhe pse i njëjti ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare duke i kuptuar më parë pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë. Mirëpo me arsyetimin se i njëjti nuk ka pasur përkthyes, mirëpo i akuzuari Elvis Drmaku ka qen edhe më parë i dyshuar dhe i akuzuar por edhe tani më i dënuar për vepra penale të kësaj natyre dhe i njëjti e ka folur gjuhën shqipe edhe në rastet e më parme ka deklarua edhe pa prezencën e përkthyesit që do të thotë se në rastin konkret i njëjti ka qenë në dijeni për deklaratën e dhënë dhe e ka kuptuar edhe deklaratat e nënshkruara. Po ashtu në rastin konkret veprat penale për të cilat akuzohet Elvis Drmaku, përbejnë vepra penale dhe nuk ekziston asnjë rrethanë që e përjashton përgjegjësinë penale të tij, pra në rastin konkret me provat të cilat mbështet aktakuza vërtetohet dyshimi i bazuar mirë se i njëjti me datë, vend dhe mënyrë si në tri pikat e dispozitivit të aktakuzës ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet, andaj gjykatës i propozoi që kërkesën për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtimin e provave ta refuzojë si të pabazuar dhe te vazhdohet me shqyrtimin gjyqësor”.
20. Më 27 dhjetor 2021, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër Aktvendimit [P. nr. 69/21] të 17 dhjetorit 2021 të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljes së kodit penal dhe Kushtetutës së Kosovës. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës i propozoi Gjykatës së Apelit që ta ndryshojë aktvendimin e kontestuar dhe ta hedhë poshtë aktakuzën [PP. II. nr. 250/19] si të pambështetur me prova dhe deklaratat e parashtruesit të kërkesës janë marrë pa praninë e një përkthyesi, përkatësisht në gjuhën shqipe që ai nuk e kupton.
21. Më 28 janar 2022, Gjykata e Apelit, me aktvendimin [PN. nr. 1297/21], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e aktvendimit të lartpërmendur, Gjykata e Apelit sqaroi ndër të tjera se “Pretendimi ankimor se të pandehurit i janë shkelur të drejtat në përdorimin e gjuhës së tij, respektivisht se deklarata e të njëjtit e dhënë në polici me datë 07.02:2019 është marrë në kundërshtim me nenin 14 të KPP-së, ngase është marrë pa praninë e përkthyesit, kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se ky pretendim nuk qëndron, është fakt si i pandehuri është marrë në pyetje nga ana e policisë me datë 07.02.2019, mirëpo i njëjti është njoftuar me të gjitha të drejtat e tij të cilat i takojnë sipas ligjit dhe me këtë edhe për të drejtën e tij në përkthim nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e personit që e drejton procedurën e marrjes në pyetje, gjë e cila vërtetohet nga procesverbali i tillë i marrjes në pyetje, e të cilin procesverbal vet i pandehuri pa kurrfarë vërejtje e ka nënshkruar. Në anën tjetër, të pandehurit Elvis Drmaku me datë 04.02.2021 i është marrë deklarata edhe në prokurori, prezent ka qenë edhe përkthyesja e gjykatës A. G., një gjë e tillë vërtetohet nga procesverbali i datës së lartcekur e të nënshkruar pa kurrfarë vërejtje nga të pranishmit, në këtë rast të drejtat e të pandehurit sa i përket përdorimit të gjuhës të cilën e kupton, janë respektuar në përpikëri dhe si rezultat i kësaj nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të mbrojtësit në këtë drejtim. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit vlerëson se nuk qëndron as pretendimi ankimor se deklaratat e të dëmtuarve F. E., G. D., dhe V.t H., nuk mund të administrohen si prova të drejtpërdrejta, për faktin se të njëjtat nuk janë siguruar në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 132 par. 6, të KPP-së. Është fakt se prokurori nuk

i ka ndërmarrë veprimet procedurale të përcaktuara në paragrafin 6, të nenit 132 të KPP-së, mirëpo një gjë e tillë nuk paraqet shkelje të atillë që kishte me kushtëzuar marrjen e një vendimi tjetër nga ai të cilin e ka marrë gjykata e shkallës së parë në aktvendimin e ankimuar, kjo sepse i pandehuri, respektivisht mbrojtja pranueshmërinë e dëshmisë së të dëmtuarve mund ta kundërshtoj edhe në fazat e mëvonshme të procedurës dhe me vet faktin e mos njoftimit nga ana e prokurorisë, mbrojtja nuk privohet nga mundësia ligjore për kundërshtimin e dëshmisë. Edhe pretendimet rreth gjendjes faktike se i pandehuri nuk është kryerës i veprave penale, tani në këtë fazë të procedurës penale janë të pabazuara, sepse ngjarja e paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit nuk mund të shqyrtohet në këtë fazë të procedurës penale, për faktin se gjykata nuk është e autorizuar të bëjë vlerësimin e provave në këtë fazë të procedurës, pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit në rastin konkret janë çështje që do të vlerësohen dhe vërtetohen në shqyrtimin gjyqësor të mëtejshëm pas administrimit të provave, ku edhe do të vërtetohet fajësia apo pafajësia e të pandehurit në rastin konkret. Prandaj, konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se me këtë çështje penale duhet të shkohet në shqyrtimin gjyqësor, në mënyrë që të bëhet administrimi i provave dhe kështu të vërtetohet drejtë gjendja faktike është i drejtë, konkludim të cilin në tërësi e mbështet edhe kjo gjykatë”.

22. Më 21 nëntor 2022, Gjykata Themelore ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në lidhje me këtë rast, ku janë marrë deklaratat e parashtruesit në cilësinë e të pandehurit, si dhe deklarata e njërit prej dëshmitarëve, pasi që dëshmitarët e tjerë nuk janë paraqitur, shqyrtimi gjyqësor është shtyrë dhe është caktuar për datën 8 dhjetor 2022 me qëllim të sigurimit të dëshmisë së dëshmitarëve të tjerë në procedurë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktvendimit të kontestuar janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 5 [Gjuhët], nenin 30 [1ë Drejtat e të Akuzuarit] të Kushtetutës si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se flet, „Gjuhen Serbe si gjuhë amtare dhe gjuhen. Gjermane pasi që është rritur në Gjermani ndërsa nuk kupton gjuhën shqipe, apo kupton shumë dobët”.
25. Në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 5 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës deklaron se nuk e flet dhe nuk e kupton gjuhën shqipe, dhe se procedura në polici është zhvilluar në gjuhën shqipe dhe rrjedhimisht ai ka disa pretendime:
- a) Në këtë çështje është evidente që i mbrojturi im nuk kupton gjuhën shqipe çka ka vërtetuar gjykata dhe prokuroria ku ka caktuar përkthyes, një pretendim i tillë i gjykatës apelit është absurd pasi që të mbrojturit tim i është dhënë për të nënshkruar një dokument gjuhën e të cilit NUK E KUPTON, andaj nuk, mund të thuhet veç se ka nënshkruar në atë dokument i janë skjaruar të drejtat e të pandehurit dhe ka kuptuar deklaratën që ka nënshkruar.*
 - b) I njëjti nuk e din gjuhën shqipe edhe pse i janë lexuar të drejtat në gjuhën shqipe nuk ka pasur se si ta kuptoj pasi që nuk e din gjuhën shqipe. Vlen të theksohet se policia i ka mohuar të drejtën në mbrojtës duke shënuar në deklaratë kinse i mbrojturi im nuk kërkon mbrojtës. Në këtë çështje aktakuza është e bazuar në deklaratën e dhënë në polici, andaj të mbrojturit tim i janë shkelur të drejtat elementare kushtetuese në këtë*

procedurë penale, e sidomos me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit nr. PN. nr. 1297/21, të datës 28.01.2022.

26. Në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës thekson: „Të pandehurit duke ju cenuar e drejta në gjuhë do të i cenohet edhe të drejtat e garantuara me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për një proces të rregullt”.
27. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata, që,

- I. TË SHPALLË kërkesën të pranueshme;*
II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje Nenin 5 [Gjuhët], Nenin 30 [Të drejtat e të akuzuarit], të Kushtetutës së Republikës dhe Nenin 6 të Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PN. nr. 1297/21 i 28. janar 2022;
IV. TA KTHEJË Aktvendimin e Gjykatës së Apelit në rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate;
V. TA URDHËROJË Gjykatën e Apelit që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Gjykatës;
VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
VII. TUA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
VIII. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Dispozitat relevante ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

[...]

Neni 5 [Gjuhët]

1. Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe.
2. Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj.

[...]

Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit]

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;

- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;
- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;
- (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;
- (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat E Njeriut

[...]

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Kodi nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE i 13 dhjetorit 2012

[...]

Neni 14

Gjuhët dhe shkrimi

- 1. Gjuha dhe shkrimet që mund të përdoren në procedurë penale janë gjuha shqipe dhe serbe, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.
- 2. Personi që merr pjesë në procedurë penale i cili nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, ka të drejtë të flasë gjuhën e vet dhe të jetë i informuar nëpërmjet përkthimit pa pagesë me faktet, provat dhe procedurën. Përkthimi sigurohet përmes një përkthyesi të pavarur.
- 3. Personi nga paragrafi 2. i këtij neni njoftohet për të drejtën e tij në përkthim. Ai mund të heqë dorë nga kjo e drejtë nëse e di gjuhën në të cilën zhvillohet procedura gjyqësore. Njoftimi për këtë të drejtë dhe deklarata e pjesëmarrësit shënohet në procesverbal.

4. Deklaratat, ankesat dhe parashtresat tjera mund të dorëzohen në gjykatë në gjuhën shqipe ose serbe, përveç nëse parashihet ndryshe me lig.
5. Personit të arrestuar, të pandehurit që mbahet në paraburgim dhe personit që mban dënimin duhet siguruar përkthimin e thirrjeve gjyqësore, vendimeve dhe parashtrësive në gjuhën të cilën ai e përdor në procedurë.
6. Shtetasi i huaj që ndodhet në paraburgim mund t'i dorëzojë gjykatës parashtresat në gjuhën e tij para, gjatë dhe pas shqyrtimit gjyqësor vetëm sipas kushteve të reciprocitetit.

[...]

Neni 240

Gjykimi penal që zbatohet vetëm pas ngritjes së aktakuzës

1. Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale apo vepra penale, procedura para gjyqit mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit.
2. Nëse hetimi ka përfunduar dhe nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale ose vepra penale, prokurori i shtetit nxjerr aktvendim për pushimin e hetimit.

[...]

Neni 242

Procedura për ngritjen e aktakuzës

1. Aktakuza i paraqitet gjykatës kompetente në aq kopje sa ka të pandehur dhe mbrojtës të tyre dhe një kopje shtesë për gjykatën. Gjithashtu, gjykatës i dërgohet edhe lënda komplete e hetimit nga prokurori i shtetit.
2. Gjykata cakton gjyqtarin ose trupin gjykues me kryetarin e tij nëpërmjet një procesi transparent e të drejtë për caktimin e çështjeve, ashtu siç duhet. Nëse është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, njëri nga gjyqtarët e kolegjit caktohet si gjyqtar i vetëm gjykues ose si kryetar i trupit gjykues ose si anëtar i trupit gjykues.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton sipas detyrës zyrtare nëse ka kompetencë mbi çështjen që përbën aktakuzën.
4. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës.
5. Nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës.
6. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton prokurorin e shtetit, të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre për kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit fillestar.

[...]

Neni 250
Kërkesa për hudhjen e aktakuzës

1. Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kërkesë për hudhjen e aktakuzës, bazuar në këto arsye:
 - 1.1 vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;
 - 1.2 ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
 - 1.3 ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është e përfshirë në falje ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose
 - 1.4 nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.
2. Prokurorit të shtetit duhet t'i jepet mundësia që të përgjigjet ndaj kërkesës gojarisht apo me shkrim.
3. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim me shkrim të arsyetuar me të cilin refuzon kërkesën ose hudh aktakuzën.
4. Secila palë mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit nga paragrafi 3. të këtij neni. Ankesa duhet të bëhet brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim.

[...]

Neni 253
Hudhja e aktakuzës

1. Për çdo kërkesë për hudhjen e aktakuzës nga neni 250 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim për hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale kur çmon se:
 - 1.1 vepra me të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;
 - 1.2 ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
 - 1.3 ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është e përfshirë me amnesti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose
 - 1.4 nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.
2. Me rastin e marrjes së aktvendimit nga ky nen, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk detyrohet me cilësimin juridik të veprës penale siç është parashtruar nga prokurori i shtetit në aktakuzë.
3. Në përgjigjen ndaj kërkesës nga neni 250, prokurori i shtetit mund të hudhë aktakuzën nëse kërkesa nga neni 250 të këtij Kodi është e bazuar.

Neni 254
Shqyrtimi i dytë dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor

1. Në shqyrtimin e dytë marrin pjesë prokurori i shtetit, i pandehuri ose të pandehurit dhe mbrojtësit, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues ka kërkuar vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e shqyrtimit të dytë.
2. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sigurohet që mbrojtësi të ketë përmbushur të gjitha detyrimet lidhur me zbulimin e provave nga neni 256 i këtij Kodi.
3. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shqyrton kundërshtimet nga neni 249 ose kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi. Ai mund të kërkojë nga prokurori i shtetit që të përgjigjet gojarisht gjatë shqyrtimit ose me shkrim, në pajtim me nenet 249- 253 të këtij Kodi.
4. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton seanca dëgjimore në pajtim me nenin 255 të këtij Kodi, nëse seancat e tilla janë të nevojshme.
5. Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse ende nuk ka marr aktvendim mbi kundërshtimet e paraqitura nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi.
6. Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ende nuk ka vendosur për kundërshtimet nga neni 249 apo kërkesat nga neni 250 të këtij Kodi, ai merr aktvendim me shkrim të arsyetuar për të gjitha propozimet e pazgjidhura pas shqyrtimit të dytë. Ai cakton shqyrtimin gjyqësor me urdhër me shkrim, të cilin e nxjerr në të njëjtën kohë me aktvendimin apo aktvendimet me shkrim për propozimet e lartpërmendura.
7. Asnjë dëshmitar apo ekspert nuk merret në pyetje dhe nuk paraqiten prova gjatë shqyrtimit të dytë.

[...]

Neni 415

Arsyet e ankesës kundër aktvendimit

1. Aktvendimi i gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues mund të ankimohet kur ai aktvendim shkel:
 - 1.1 të drejtën e cila i njihet palës me Kushtetutën e Republikës së Kosovës,
 - 1.2 të drejtën thelbësore të palës të paraparë me këtë Kod,
 - 1.3 të drejtën thelbësore të palës të paraparë me ndonjë ligj tjetër të Kosovës; dhe
 - 1.4 të drejtën procedurale që ka për qëllim garantimin e të drejtës nga nën-paragrafët 1.1. deri 1.3. të këtij neni; dhe
2. Pala e cila kundërshton aktvendimin e gjykatës themelore duhet të demonstrojë se shkelja e së drejtës i shkakton asaj dëm të parevokueshëm.
3. Nëse arsyet e ankesës nuk janë në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, Gjykata e Apelit mund të hudhë ankesën. Ankesa e cila hudhet sipas këtij paragrafi mund të paraqitet sërish me ankesë kundër aktgjykimit nga neni 380 i këtij Kodi.

[...]

Neni 416

Vendimet mbi ankesën kundër aktvendimit

1. Me përjashtim të rasteve kur parashihet ndryshe me këtë Kod, ankesat kundër aktvendimit të gjykatës themelore vendosen në seancë të kolegjit të Gjykatës së Apelit.
2. Kur vendos për ankesë, gjykata me aktvendim mund ta hudhë ankesën si të paafatshme ose të papranueshme, ta refuzojë si të pabazë, ta aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktvendimin ose ta anulojë dhe, sipas nevojës, çështjen ta kthejë për rivendosje.
3. Kur vendos mbi ankesën kundër aktvendimit me të cilin hudhet aktakuza, gjykata mund të refuzojë ankesën e tillë me aktgjykim nëse mëson se ka arsye për aktgjykim të tillë.
4. Kur e shqyrton ankesën, gjykata interesohet sipas detyrës zyrtare për të mësuar nëse gjykata themelore ka pasur kompetencë lëndore për marrjen e aktvendimit dhe nëse aktvendimi është marrë nga organi i autorizuar.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuar më tej dhe Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe lirite e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individu mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

*Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

*Neni 49
(Afatet)*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

31. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar se konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht aktvendimin e Gjykatës së Apelit PN. nr. 1297/21 të 28 janarit 2022, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se janë shkelur, në pajtim me kriteret e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
32. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

33. Gjykata po ashtu thirret edhe në rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, ku thuhet:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) anë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.”

34. Gjykata rikujton se rregulli për shterjen e mjeteve juridike nga neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit dhe rregulli 39 (1) (b) i Rregullores së punës i obligon personat fizikë dhe juridikë të cilët dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre para Gjykatës Kushtetuese të shfrytëzojnë fillimisht mjetet juridike efektive, të cilat janë në dispozicion me ligj, kundër aktgjykimit, aktvendimit ose vendimit të kontestuar.

35. Në këtë mënyrë, organeve administrative dhe gjykatave të rregullta u jepet mundësia të parandalojnë dhe korrigjojnë shkeljet e mundshme kushtetuese përmes procedurave të rregullta administrative dhe gjyqësore, përpara se rasti të vij në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik në Kosovë ofron mjete juridike efektive për parandalimin dhe korrigjimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt shumë i rëndësishëm i karakterit subsidiar të mekanizmit të së drejtës kushtetuese (shih ndër të tjera rastet e Gjykatës: KI67/19, parashtrues *Hajrije Rina Zhitija Ajeti*, aktvendim për papranueshmëri i datës 30 shtator 2019, paragrafi 34; KI09/19, parashtrues *Leutrim Hajdari*, aktvendim për papranueshmëri i datës 16 mars 2020, paragrafi 36; KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, aktvendim për papranueshmëri i datës 7 gusht 2017, paragrafi 35, dhe KI94/14, Aktvendim për papranueshmëri parashtrues *Sadat Ademi* i datës 17 dhjetor 2014, paragrafi 24).
36. Në këtë drejtim, Gjykata dëshiron të theksojë qëndrimin konsistent se mekanizmi mbrojtës për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese nga Gjykata Kushtetuese ka karakter subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor (shih rastet e Gjykatës KI15/16, parashtrues *Ramadan Muja*, Aktvendimi për papranueshmëri i datës 16 mars 2016, paragrafi 42 dhe KI178/21, parashtrues *Agim Stublla* aktvendimi për papranueshmëri i datës 11 shkurt 2022, paragrafi 27).
37. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi duhet të ketë mundësinë të përdorë mjetet ligjore që janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të korrigjuar shkeljet e pretenduara kushtetuese. Ekzistenca e mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë atyre mjeteve juridike do t'u mungojnë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm. Kjo është në përputhje me vendimin e GJEDNJ-së dhe në lidhje me detyrimin e parashtruesve për të shterur të gjitha mjetet juridike (shih, ndër të tjera, *Vernillo kundër Francës*, paragrafi 27, kërkesa nr. 11889/85 Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i datës 20 shkurt 1991, dhe *Dalia kundër Francës*, paragrafi 38, kërkesa nr. 26102/95, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i datës 19 shkurt 1998).
38. Prandaj, i takon Gjykatës të shqyrtojë nëse mjetet juridike ishin shteruar dhe, nëse jo, nëse parashtruesi i kërkesës kishte në dispozicion ndonjë mjet juridik efektiv, në teori dhe në praktikë. Prandaj, Gjykata duhet të sigurojë që mjete juridik të jetë në dispozicion, si dhe të ofrojë mundësi të arsyeshme për të korrigjuar shkeljet e mundshme kushtetuese që janë deklaruar nga parashtruesi në Gjykatën Kushtetuese (shih rastin e sipërpërmendur të Gjykatës KI41/20, parashtrues *Shaqir Krasniqi*, paragrafi 23, shih gjithashtu rastin e mësipërm KI178/21, parashtrues *Agim Stublla*, paragrafin 29 dhe shih, ndër të tjera, *Civet kundër Francës*, paragrafët 42-44, kërkesën nr. 29340/95, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 28 shtatorit 1999).
39. Megjithatë, kur mjeti juridik parashkohet me ligj, i takon parashtruesit të dëshmojë se mjeti juridik i parashikuar nga ligji ishte me të vërtetë i shteruar ose për ndonjë arsye ishte i padisponueshëm dhe i paefektshëm në rrethanat e veçanta të rastit ose ekzistonin rrethana të veçanta për shkak të të cilave parashtruesi u lirua nga kushti i shterimit të mjeteve juridike.
40. Gjykata rikujton se objekt i vlerësimit të kërkesës së parashtruesit është Aktvendimi [Pn.br 1297/21] i Gjykatës së Apelit me të cilin është refuzuar kërkesa për hudhjen e aktakuzës [PP. II. nr. 250/2019] së Prokurorisë Themelore.

41. Prandaj, për sa i përket plotësimin të kushteve të sipërpërmendura, Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar dhe se konteston aktin e organit publik, gjegjësisht aktvendimin [Pn.nr.1297/21]. e Gjykatës së Apelit, të datës 28 janar 2022.
42. Rrjedhimisht, bazuar në faktin se akti kontestuar nga parashtruesi është Aktvendimi [Pn.nr.1297/21] i Gjykatës së Apelit i datës 28 janar 2022 në lidhje me refuzimin e kërkesës për hudhjen e aktakuzës. [PP. II. nr. 250/2019] të Prokurorisë Themelore të datës 9 shkurt 2019, të ngritur kundër tij për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë në vazhdimësi nga neni 327 paragrafi 1 në lidhje me nenin 81 të KPRK-së dhe për veprën penale vjedhje në vazhdimësi, nga neni 325, paragrafi 2, lidhur me nenin 81 të KPRK-së, Gjykata do të shqyrtojë më tej plotësimin e kushtit të shterimit të mjeteve juridike.
43. Në lidhje me aktin e kontestuar, pra aktvendimin (PN. nr. 1297/21) e Gjykatës së Apelit, parashtruesi pretendon shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij të garantuara nga neni 5 [Gjuhët] dhe Neni 30 [Të drejtat e të akuzuarit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për gjykim të drejtë) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës shprehet në mënyrë specifike se e drejta e tij për gjuhën dhe e drejta për një avokat mbrojtës janë shkelur.
44. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij nuk e informoi Gjykatën për procedurën që ishte zhvilluar pas ngritjes së aktakuzës në Gjykatën Themelore. Lidhur me këtë, Gjykata Themelore në përgjigjen e saj ndaj kërkesës për informata të dërguara nga Gjykata, ka njoftuar Gjykatën se procedura penale është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në mbështetje të këtij informacioni, Gjykatën e njoftoi edhe Prokuroria Themelore se për datën 8 dhjetor 2022 është caktuar vazhdimi i seancës kryesore, ku me propozim të prokurorisë do të dëgjohen dëshmitarët, duke theksuar se të gjitha seancat janë mbajtur në praninë e përfaqësuesve dhe me përkthyes gjyqësor.
45. Pas shtjellimit të lartpërmendur, Gjykata, duke iu referuar dispozitave ligjore, gjegjësisht dispozitave të procedurës penale, vëren se në bazë të nenit 240. 04/L-123 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK), procedura e ngritjes së aktakuzës fillon pas përfundimit të hetimeve. Rrjedhimisht, neni 242 i KPPRK përcakton se aktakuza e ngritur nga prokuroria i dorëzohet gjykatës kompetente, e cila cakton seancën e parë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e ngritjes së aktakuzës nga prokuroria. Pas kësaj, në pajtim me nenin 250 të KPPRK-së, përcaktohet se pas shqyrtimit të parë dhe para seancës së dytë, të pandehurit kanë të drejtë të iniciojnë procedurën e hudhjes së aktakuzës. Në bazë të dispozitave të KPPRK-së, gjegjësisht nenit 254, me përfundimin e shqyrtimit të kërkesës për hudhjen e aktakuzës, dhe në rast se refuzohen kundërshtimet dhe ankesat e të pandehurve për hudhjen e aktakuzës, fillon procedura gjyqësore kryesore.
46. Për sa më sipër, Gjykata vëren se procedura penale është në fazën e dytë të shqyrtimit pranë Gjykatës Themelore. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës mund të parashtrtojë pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, duke përfshirë të drejtën e gjuhës dhe të drejtën për një avokat mbrojtës, të garantuar nga nenet 5 dhe 30 të Kushtetutës, në procedimin penal të zhvilluar në Gjykatën Themelore. Prandaj, përderisa çështja në lidhje me aktakuzën e kontestuar të prokurorisë është në vazhdim dhe parashtruesi i kërkesës ka mjete juridike në dispozicion para gjykatave të rregullta për të kundërshtuar shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata nuk mund të vlerësojë dhe të paraqesë konkluzionin e saj lidhur me shkeljet e pretenduara.

47. Gjykata respekton vazhdimisht parimin e subsidiaritetit, duke konsideruar se të gjithë parashtruesit duhet të shterojnë të gjitha opsionet procedurale në procedurat para gjykatave të rregullta në mënyrë që të parandalojnë shkeljen e Kushtetutës ose, nëse ka, të eliminojnë një shkelje të tillë të së drejtës themelore të garantuara me Kushtetutë.
48. Siç e ka theksuar vazhdimisht Gjykata përmes praktikës së saj gjyqësore, qëllimi dhe arsytimi i detyrimit për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit është t'u ofrojë organeve përkatëse, kryesisht gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Ajo bazohet në supozimin e përfshirë në nenin 32 [E drejta për mjet juridik] të Kushtetutës dhe nenin 13 (E drejta për mjet juridik efektiv) të KEDNJ-së se rendi juridik i Republikës së Kosovës ofron një mjet efektiv për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së: *Selmouni kundër Francës*, kërkesa nr. 25803/94, aktgjykimi i 28 korrikut 1999, paragrafi 74; shih gjithashtu rastin e Gjykatës: KI135/17, parashtrues: KI135/17, *Borçe Petrovski*, aktvendimi për papranueshmëri i datës 17 janar 2018, paragrafët 62-66 dhe referencat e përdorura në të).
49. Së fundi, Gjykata vendos se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme dhe duhet të refuzohet, si e papranueshme, bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (b) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 qershor 2023, njezëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selyete Gërxhaliu Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani